



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**

---

**Ac.nr.982/2020**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, kolegji në përbërje nga gjyqtari Valon Totaj - kryetar i kolegjit dhe gjyqtarëve Milena Djerić e Rafet Haxhaj – anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit F.S. nga Prishtina, rr. "...", p.n., Qagllavicë, kundër të paditurave Zyra e Kryeministrit e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Ministria e Financave, Ministria e Drejtësisë në Prishtinë, të cilat i përfaqëson me autorizim avokati i shtetit Arsim Zuka, për shkak të kompensimit të pagave duke vendosur sipas ankesës së paditësit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.599/16, të datës 07.10.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 22.09.2021, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e paditësit F.S. nga Prishtina, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.599/16, i datës 07.10.2019, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë, me pikën I të aktgjykimit të ankimuar C.nr.599/16, të datës 07.10.2019, e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit F.S. nga Prishtina, rr. "...", p.n. Qagllavicë, me të cilën ka kërkuar që të detyrohen të paditurat Zyra e Kryeministrit e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Ministria e Financave dhe Ministria e Drejtësisë në Prishtinë, që paditësit t’ia kompensojnë diferencën e pagave në mes të udhëheqësit të divizionit për përfaqësime dhe avokatit të përgjithshëm shtetëror për periudhën nga data 24.04.2013, deri më datën 06.06.2016, në shumën prej 15,312.58 euro, si dhe t’ia paguaj kamatën prej 8%, nga dita e ushtrimit të padisë me datën 17.03.2016, deri më 31.08.2019, në shumën prej 4,421.91 euro, në emër të kontributit pensional shumën prej 1,790.95 euro, në Trustin e Kursimeve Pensionale në emër të paditësit, si dhe në emër të tatimit në diferencë në paga shumën prej 1,701.40 euro, në Administratën Tatimore të Kosovës, e po ashtu t’ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 115.00 euro, të gjitha këto në afat prej 7(shtatë) ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit. Me pikën II të aktgjykimit është vendosur që se cila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi, paditësi, në afatin ligjor, ka paraqitur ankesë dhe atë për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë, ta aprovoj ankesën e tij si të bazuar dhe të detyroj të paditurën që të njëjtit t'ia kompensojë shumën prej 23,339 euro, me kamatë prej 8% në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarrimit.

E paditura nuk ka parashtruar përgjigje në ankesën e paditësit.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore në ankesë lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- ankesa e paditësit, është e **pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi me datën 17.03.2016, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi kundër të paditurave, për kompensimin e pagave, me arsye sikurse në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimin e të gjitha shkresave të lëndëve, ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar C.nr.599/16, të datës 07.10.2019, me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimin të ankimuar. Në arsyetim të tij gjykata ka theksuar se mes palëve ndërgjyqëse nuk është kontestues fakti se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune të e paditura Ministria e Drejtësisë, në pozitën Udhëheqës i Divizionit, dhe se të njëjtit i ka përfunduar marrëdhënien e punës me datën 04.06.2016 me arritjen moshës së pensionimit. Ky fakt vërtetohet në bazë të Kontratës së Punës e datës 08.08.2011 dhe me Akt Emërimit të datës 08.08.2012. Ndërsa mes palëve ndërgjyqëse kontestuese ishte fakti se a i takon paditësit e drejta e kompensimit të diferencës së pagës në mes të pozitës së udhëheqësit të divizionit dhe avokatit të përgjithshëm shtetëror bazuar në Ligjin mbi Avokaturën Shtetërore, nga data 24.04.2013, kur ka hy në fuqi ligji në fjalë, e deri me datën 04.06.2016, kur paditësi është pensionuar. Gjykata e shkallës së parë ka theksuar se kërkesëpadija e paditësit është e pabazuar për faktin se në asnjë dispozitë ligjore të Ligjit për Avokaturën Shtetërore, nuk është paraparë që me hyrje në fuqi të këtij ligji, udhëheqësi i divizionit, në këtë rast paditësi, të emërohet avokat i përgjithshëm shtetëror. Tutje gjykata në fjalë ka vlerësuar se në rastin konkret kërkesëpadija e paditësit është e pabazuar për faktin se i njëjti ka kërkuar kompensimin e diferencës në mes pagës së udhëheqësit të divizionit për përfaqësime dhe avokatit të përgjithshëm shtetëror, edhe pse i njëjti asnjëherë nuk ka qenë i emëruar në pozitën e avokatit të përgjithshëm shtetëror. Pra gjykata vlerësoi se paditësi nuk mund të realizoj pagën e avokatit shtetëror pa qenë i emëruar në këtë pozitë. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është nxjerrë në mbështetje të nenit 450 të LPK.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni

182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditësit për shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore, pasi që dispozitivi i aktgjykimit është i qartë dhe i kuptueshëm. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme për mënyrën e vendosjes në këtë çështje juridike kontestimore duke arsyetuar të gjitha faktet vendimtare të cilat kanë ndikuar që e njëjta të vendosë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, të cilat arsye janë të pranueshme edhe për gjykatën e shkallës së dytë. Po ashtu sipas vlerësimit të kësaj gjykate, në mes të arsyeve të paraqitura nuk ekzistojnë kundërthënie, në ndërkohë që kundërthënie nuk ka as në mes të dispozitivit dhe arsyetimit të aktgjykimit.

Edhe gjendja faktike në këtë procedurë është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, për çka nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palës ankuese as për këtë bazë, për arsye se gjykata e shkallës së parë në procedurën e të provuarit përmes mjeteve provuese i ka vërtetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për këtë çështje juridike. Andaj pretendimet e tij mbi këtë bazë, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, nuk qëndrojnë, për arsye që gjykata e shkallës së parë në procedurën e të provuarit përmes mjeteve provuese që i ka cekur në arsyetim të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, e të cilat gjykata e shkallës së dytë nuk e pa të arsyeshme që t'i përsërisë edhe njëherë, i ka vërtetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për këtë çështje juridike, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Gjykata ankimore e pranon në tërësi përfundimin e gjykatës së shkallës së parë edhe për zbatimin e rregullt dhe të drejtë edhe të dispozitave materialo - juridike nga edhe ka rrjedhur përfundimi se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar. Me dispozitën e nenit 29 par.2 të Ligjit për Avokaturën Shtetërore është e paraparë se *“Të gjithë zyrtarët ligjorë në divizionin për përfaqësimë që kanë ushtruar detyrat e përfaqësimit të institucioneve publike dhe që i plotësojnë kushtet sipas ligjit për tu emëruar avokat shtetëror, do të kenë statusin e avokatit shtetëror.”* Mbi bazën e kësaj gjendje faktike të vërtetuar dhe në kuptim të dispozitës ligjore të lartcekur rezulton se gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, pasi që i njëjti nuk e ka ushtruar pozitën e avokatit **të përgjithshëm** shtetëror, por atë të udhëheqësit të divizionit për përfaqësimë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë për pabazueshmërinë e kërkesëpadiës së paditësit në këtë procedurë, është i drejtë dhe i argumentuar, për çka me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka vendosur sikurse në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar.

Edhe vendimi mbi shpenzimet e procedurës është i drejtë dhe në pajtim me nenin 450 të LPK.

Gjykata e Apelit i analizoi dhe mori për bazë edhe pretendimet e tjera ankimore të paditësit, por vlerësoi se të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, prandaj në

mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 paragrafi 1 pika (d), lidhur me nenin 200 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Ac.nr.982/2020, me datën 22.09.2021**

**Kryetari i kolegjit - Gjyqtari**  
**Valon Totaj**